

RAPORT I PËRKOHSHËM 11 mars - 2 prill 2019

5 prill 2019

I. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

Zgjedhjet presidenciale në Maqedoninë e Veriut do të mbahen më 21 prill. Për t'u zgjedhur në rrethin e parë, kandidati duhet të fitojë shumicën e votave të të gjithë votuesve të regjistruar. Rrethi i dytë, nëse ka nevojë, do të mbahet më 5 maj, për të përcaktuar fituesin, i cili duhet ta fitojë shumicën e votave me kusht që pjesëmarrja e votuesve të jetë së paku 40 për qind. Përndryshe, procesi zgjedhor do të përsëritet.

Korniza ligjore pësoi disa ndryshime kohëve të fundit, duke përfshirë ndryshime të imta të Kodit Zgjedhor, të cilat u miratuan më 27 mars. Disa dispozita të ligjit, duke i përfshirë ato që kanë të bëjnë me zhvillimin e fushatës, financimin e fushatës dhe mediat, nuk e pasqyrojnë garën për zgjedhjet presidenciale dhe zbatimimi i tyre nuk është gjithmonë i qartë për palët e interesuara të MVZ-së së ODIHR-it.

Zgjedhjet administrohen nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ), 80 Komisione Zgjedhore Komunale (KZK) dhe 3.396 Këshilla Zgjedhore (KZ). KSHZ-ja deri tani i ka bërë përgatitjet në përputhje me dispozitat ligjore dhe mban mbledhje të rregullta të hapura. KZK-të e vizituara nga MVZ-ja e ODIHR-it deri më tani kanë resurse të mjaftueshme, i kanë formuar KZ-të dhe kanë filluar me trajnimin e KZ-ve.

Regjistri i votuesve administrohet nga KSHZ-ja dhe përfshin rreth 1.8 milion qytetarë, të cilët kanë së paku 18 vjet dhe kanë dokumente të vlefshme identifikimi. Votuesit mund t'i kontrollojnë të dhënat onlajn dhe mund të kërkojnë ndryshime gjatë gjithë vitit. Pas një periudhe trejavore të këqyrjes publike, kopje të listave iu dhanë partive politike parlamentare, me kërkesë të tyre.

Shtetasit që kanë mbushur së paku 40 vjet, me vendbanim në vend nga më së paku 10 nga 15 vitet e fundit, kanë të drejtë të kandidojnë për kryetar të vendit. KSHZ-ja regjistroi tre kandidatë, duke përfshirë një grua dhe një shqiptar etnik, secili prej të cilëve mbledhi së paku 10.000 nënshkrime për mbështetje nga votuesit. Edhe pse jo-partiakë, secili kandidat u mbështet nga parti politike para regjistrimit të tyre.

Fushata zgjedhore filloi më 1 prill, kur të gjithë kandidatët mbajtën ngjarje të hapjes së fushatës. Gjatë periudhës para fushatës, kandidatët nuk zhvilluan fushatë pas regjistrimit të tyre më 21 mars, por partitë politike ishin aktive gjatë kësaj kohe, duke i kritikuar kundërshtarët e tyre dhe duke i mbështetur kandidatët presidencialë pas të cilëve qëndrojnë.

Donacionet dhe shpenzimet e fushatës realizohen nëpërmjet llogarive të veçanta bankare të kandidatëve, dhe për to duhet të dorëzohen raporte të përkohshme dhe përfundimtare. Nuk ka rregulla eksplicite për zhvillimin e fushatës nga palët e treta. Disa institucione kanë mandat që përputhen ndërmjet tyre për t'i mbikëqyrur rregullat financiare të fushatës.

Ambienti mediatik është i shumëllojshëm me burime të shumta, por me një treg të kufizuar të reklamave. Korniza ligjore i përcakton obligimet e mediave në fushatë, por zbatimimi i këtyre dispozitave për zgjedhjet presidenciale është i paqartë. Transmetuesi publik është i obliguar të emetojë

paraqitje politike falas, ndërsa llojet e tjera të mediave, duke i përfshirë edhe portalet në internet, kanë të drejtë të ofrojnë reklama të paguara, të cilat do të kompensohen nëpërmjet mjeteve publike.

KSHZ-ja e trajton shumicën e kundërshtimeve zgjedhore, ndërsa Enti Shtetëror i Revizionit dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit kanë për detyrë t'i shqyrtojnë kundërshtimet në lidhje me financimin e fushatës dhe keqpërdorimin e burimeve administrative, respektivisht. Deri më sot, janë parashtruar shumë pak kundërshtime në lidhje me zgjedhjet, edhe atë në lidhje me përfshirjen nga lista e votuesve, regjistrimin e kandidatëve dhe zhvillimin e fushatës.

II. HYRJE

Në përgjigje të ftesës nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në përputhje me mandatin e saj, Zyra për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut e OSBE-së (ODIHR) më 11 mars e krijoi Misionin për vëzhgimin e zgjedhjeve (MVZ). MVZ-ja e udhëhequr nga znj. Corien Jonker, përbëhet nga 11 anëtarë të ekipit kryesor në Shkup dhe 18 vëzhgues afatgjatë të shpërndarë në mbarë vendin që nga 20 marsi. Anëtarët e misionit janë siguruar nga 19 vende pjesëmarrëse të OSBE-së. ODIHR-i ka kërkuar që vendet pjesëmarrëse të sigurojnë 250 vëzhgues afatshkurtër për ta vëzhguar votimin e hershëm më 20 prill dhe hapjen, votimin, numërimin dhe nxjerrjen e rezultateve më 21 prill.

III. SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK

Më 8 shkurt të vitit 2019, kryetari i Kuvendit i shpalli zgjedhjet presidenciale për më 21 prill. Kryetari aktual i vendit, Gjorge Ivanov, për herë të parë u zgjodh në vitin 2009, i mbështetur nga partia e atëhershme në pushtet, Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE), ndërsa u rizgjodh për mandatin e dytë dhe të fundit në prill të vitit 2014. Kriza e zgjatur politike në vitet në vijim çoi në mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në dhjetor të vitit 2016, të cilat në fund rezultuan me qeveri të re të udhëhequr nga Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM) në koalicion me partinë e shqiptarëve etnikë që kishte numrin më të madh të deputetëve, Bashkimin Demokratik për Integritet (BDI), e cila më parë ka qenë në koalicion me VMRO-DPMNE-në.¹

Ambienti politik tradicionalisht është i ndarë kryesisht përgjatë vijave etnike, ku partitë kryesisht garojnë për votat brenda bashkësive të tyre etnike, ndërsa koalicionet qeveritare formohen përtej ndarjes etnike, duke përfshirë edhe parti etnike shqiptare. Në këto zgjedhje, dy kandidatë, Stevo Pendarovski dhe Gordana Siljanovska Davkova, u mbështetën nga dy blloqe politike të udhëhequra nga LSDM-ja dhe VMRO-DPMNE-ja.² Kandidatura e z. Pendarovskit poashtu u mbështet nga BDI-ja dhe partitë e tjera etnike shqiptare të koalicionit qeveritar. Kandidati i tretë, Blerim Reka, është mbështetur nga dy parti etnike shqiptare në opozitë, Aleanca për shqiptarët (ASH) dhe BESA.³ Të tre kandidatët janë personalitete jo-partiake.

Zgjedhjet mbahen në kontekst të zhvillimeve të rëndësishme për marrëdhëniet e vendit brenda rajonit dhe ambiciet e saj për t'u anëtarësuar në Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) dhe Bashkimin Evropian (BE). Më 30 shtator të vitit 2018, u mbajt një referendum konsultativ për marrëveshjen bilaterale me Greqinë ("Marrëveshja e Prespës"), me të cilën parashihej ndryshimi i

¹ Në koalicionin në pushtet, blloku i udhëhequr nga LSDM-ja ka 49 deputetë, BDI-ja - 10, AlternativA - 3, dhe Partia Demokratike Shqiptare - 2. Blloku opozitar i udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja ka 51 deputetë, Aleanca për Shqiptarët - 3, dhe BESA - 2. Dyzet e pesë deputetë janë gra, ndërsa 23 identifikohen si shqiptarë etnikë.

² Z. Pendarovski më parë kandidoi për kryetar të vendit në vitin 2014, me ç'rast edhe atëherë u mbështet nga LSDM-ja.

³ Besa do të thotë "besë" në shqip.

emrit kushtetues të vendit. Pyetja e referendumit u miratua nga 91.5 e atyre që votuan, me pjesëmarrje të votuesve prej 36.9 për qind.⁴ Parlamenti vazhdoi me miratimin e ndryshimeve kushtetuese, të cilat u miratuan më 11 janar 2019 me shumicë prej dy të tretave.

IV. SISTEMI ZGJEDHOR DHE KORNIZA LIGJORE

Kryetari i vendit zgjidhet në zgjedhje të përgjithshme të drejtpërdrejta sipas sistemit të shumicës me mandat prej pesë vjetësh. Personi i njëjtë nuk mund të zgjidhet për kryetar të vendit më shumë se dy herë. Për t'u zgjedhur në rrethin e parë, kandidati duhet të fitojë shumicën e votave të të gjithë votuesve të regjistruar. Nëse asnjë kandidat nuk e plotëson këtë kusht, mbahet rrethi i dytë brenda dy javëve ndërmjet kandidatëve të kanë fituar numrin më të madh të votave. Në rrethin e dytë, zgjidhet kandidati që e ka fituar shumicën e votave, me kusht që të ketë pjesëmarrje të votuesve prej së paku 40 për qind të votuesve të regjistruar. Përndryshe, procesi zgjedhor përsëritet. ODIHR-i dhe Komisioni i Këshillit të Evropës për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venedikut) më parë e kanë kritikuar kushtin e pjesëmarrjes së votuesve pasi që mund të çojë në cikle të zgjedhjeve të dështuara.

Zgjedhjet presidenciale kryesisht janë të rregulluara me Kushtetutën e vitit 1991 dhe Kodin Zgjedhor të vitit 2006.⁵ Me disa ndryshime të Kodit Zgjedhor në vitin 2018 dhe 2019 u përshtat formula për përbërjen e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), u zvogëlua numri i anëtarëve të komisionit, u zgjeruan kompetencat e tij, dhe u parapa kompensim për reklamimin e paguar politik nga buxheti shtetëror. Sipas disa bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, ndryshimet ligjore u miratuan me ngut nga Kuvendi, dhe pa konsultim domethënës me palët e interesuara.

Disa rekomandime të mëparshme të ODIHR-it mbeten të patrajtuara, duke i përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me të drejtën e kandidimit, privimin e të drejtës së votës në bazë të vendimit gjyqësor, shqyrtimin e detajuar të raporteve të përkohshme për financimin e fushatës, dhe kufizimet ligjore në lidhje me cilësinë e parashtruesit të kundërshtimeve. Disa dispozita të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me fushatën, financimin e fushatës dhe mediat, nuk e pasqyrojnë garën për zgjedhjet presidenciale dhe sipas bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, zbatimi i tyre nuk është i qartë.⁶ Udhëzimet e miratuara nga KSHZ-ja për këto zgjedhje, kryesisht e përsërisin Kodin zgjedhor dhe nuk ofrojnë qartësim plotësues.⁷ Ndryshime të imta të Kodit Zgjedhor u miratuan nga Kuvendi më 27 mars, me ç'rast u shtua fjala "kandidatët" pranë partive politike për t'i qartësuar dispozitat që kanë të bëjnë me fushatën. Këto ndryshime ligjore në momentin e fundit nuk i trajtuan të gjitha mangësitë ekzistuese në rregullativën për zgjedhjet presidenciale, dhe ende nuk kanë hyrë në fuqi.⁸

⁴ Ligji për referendumin parasheh një kufi të pjesëmarrjes prej 50 për qind, por gjithashtu parasheh edhe referendume konsultative.

⁵ Korniza ligjore po ashtu e përfshin Ligjin për Partitë Politike të vitit 2004, Ligjin për Financimin e Partive Politike të vitit 2004, Kodin Penal të vitit 1996, Ligjin për Media të vitit 2013 dhe Ligjin për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike të vitit 2013 dhe udhëzimet e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

⁶ Disa nga këto dispozita u referohen garuesve si anëtarë të aleancave të partive parlamentare në pushtet ose opozitare dhe nuk i përmendin kandidatë presidencialë të emëruar nga votuesit.

⁷ Në zbatimin e këtyre dispozitave të Kodit Zgjedhor, KSHZ-ja vendosi që hapësira e bilbordeve komerciale duhet të ndahet midis kandidatëve presidencialë në bazë të mbështetjes së partisë së tyre politike, pavarësisht nga fakti se të tre kandidatët u regjistruan si kandidatë jo-partiakë. Me këtë vendim kandidati i mbështetur nga partitë në pushtet fitoi 40 për qind të hapësirës së përgjithshme, ndërsa 40 për qind të tjera u ndanë ndërmjet dy kandidatëve të mbështetur nga partitë opozitare dhe 20 për qind të mbetura do të ndahen ndërmjet tre kandidatëve sipas marrëveshjes së tyre të ndërsjellë.

⁸ Ligji nuk është nënshkruar nga kryetari i vendit e as nuk është shpallur në Gazetën zyrtare. Kryetari i vendit ka refuzuar t'i nënshkruajë të gjitha ligjet që nga ndryshimet kushtetuese në shkurt të vitit 2019, me të cilat u ndryshua emri i vendit.

V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet presidenciale administrohen nga administrata në tre nivele, që përbëhet nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ), 80 Komisione Zgjedhore Komunale (KZK), dhe 3.396 Këshilla Zgjedhorë (KZ). Votimi jashtë vendit do të zhvillohet në 32 zyra diplomatike dhe konsullore në 24 vende. Votimi i hershëm do të administrohet me kuti të lëvizshme të votimit për votuesit në shtëpi, votuesit në institucionet ndëshkuese dhe personat e zhvendosur në brendi të vendit më 20 prill.⁹

Pas ndryshimeve në Kodin Zgjedhor në vitin 2018, KSHZ-ja përbëhet nga shtatë anëtarë të emëruar nga partitë politike parlamentare: katër nga partitë në pushtet, duke përfshirë nënkryetarin dhe tre nga partitë opozitare, duke përfshirë edhe presidentin. Tre nga anëtarët e KSHZ-së janë gra, njëra prej të cilave është nënkryetare. Mandati i KSHZ-së aktuale, i cili fillimisht ishte caktuar për gjashtë muaj për ta administruar referendumin e vitit 2018, në nëntor të vitit 2018 u zgjat më së shumti deri në dy vjet.

KZK-të përbëhen nga pesë anëtarë dhe zëvendësit e tyre, të zgjedhur në mënyrë të rastësishme nga KSHZ-ja nga radhët e punonjësve të administratës shtetërore dhe komunale me mandat prej pesë vjetësh. KZK-të e mbikëqyrin administrimin e zgjedhjeve në komunën përkatëse, i emërojnë dhe i trajtojnë KZ-të, dhe menaxhojnë me përgatitjet e tjera teknike. KZ-të përbëhen nga tre anëtarë të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme nga KZK-të nga radhët e nëpunësve publikë dhe shtetërorë me mandat katërvjeçar dhe dy anëtarë të përkohshëm të emëruar nga partitë parlamentare për çdo zgjedhje.¹⁰ KZK-të dhe KZ-të aktuale janë emëruar në vitin 2017. Përbërja e çdo organi për menaxhim të zgjedhjeve duhet t'i respektojë kërkesat ligjore për përfaqësimin gjinor dhe etnik.¹¹ Garuesit mund të emërojnë përfaqësues të autorizuar në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore për ta monitoruar punën e tyre dhe të tre kandidatët kanë caktuar përfaqësues në KSHZ.

Deri tani KSHZ-ja i ka bërë përgatitjet në përputhje me afatet kohore ligjore. Komisioni ka mbajtur mbledhje të rregullta, të cilat ishin të hapura për publikun dhe mediat, ndërsa procesverbalet nga shumica e mbledhjeve dhe vendimet e miratuara janë publikuar në ueb-faqen e KSHZ-së.¹² Megjithatë, në shumicën e rasteve, mbledhjet nuk u lajmëruan paraprakisht publikisht.

KSHZ-ja ka paraparë një program trajnimi pilot për kryetarët e KZ-ve dhe zëvendësit e tyre, përveç trajnimeve të rregullta për të gjithë anëtarët e KZ-ve që mbahen nga ana e KZK-ve. KSHZ-ja e informoi MVZ-në e ODIHR-it se materialet për trajnim do të përgatiten në pesë gjuhë.¹³ KSHZ-ja përgatiti një fushatë për edukimin e votuesve për emetim në mediat transmetuese, mediat onlajn dhe rrjetet sociale në pesë gjuhë. Sipas KSHZ-së, kjo fushatë për edukim përmban informata për të drejtat e votuesve, procedurat e votimit, dhe për denoncimin e shkeljeve zgjedhore.

Sipas KSHZ-së, të gjitha KZK-të filluan me punën e tyre sipas planit të paraparë. KZK-të e vëzhguara nga MVZ-ja e ODIHR-it deri më tani duket se posedojnë me burime adekuate materiale dhe financiare për mbajtjen e zgjedhjeve. Mbledhjet e KZK-ve kryesisht janë mbajtur *ad hoc* (sipas

⁹ Për herë të parë, votimi i hershëm do të jetë i mundshëm në një shtëpi pleqsh dhe në një spital special në Shkup. Votimi i hershëm do të mundësohet nga 18 prilli në KSHZ për anëtarët e KZ-ve që do ta administrojnë votimin jashtë vendit.

¹⁰ Partitë në pushtet dhe ato opozitare emërojnë nga një kandidat dhe zëvendës. Emërimet për KZ-të aktuale u bënë nga koalicioni në pushtet i LSDM-së dhe BDI-së, si dhe VMRO-DPMNE-ja dhe BESA nga partitë opozitare.

¹¹ Çdo gjini duhet të përfaqësohet nga të paktën 30 për qind e anëtarëve, e po ashtu duhet të përfaqësohen edhe të gjitha bashkësitë etnike që përbëjnë të paktën 20 për qind të popullsisë në komunën përkatëse.

¹² Për herë të parë, disa mbledhje të KSHZ-së kishin interpretim në gjuhën e shenjave në maqedonisht.

¹³ Përveç në gjuhën maqedonase, KSHZ-ja planifikon që doracakun e trajnimit ta publikojë edhe në gjuhën shqipe, rome, serbe dhe turke. Sipas KSHZ-së, në radhët e trajnuesve të certifikuar nga KSHZ-ja ka pjesëtarë të këtyre komuniteteve dhe ata janë shpërndarë në komunat me popullatë të konsiderueshme të pakicave.

nevojës), dhe vendimet nuk janë publikuar gjithmonë në hapësirat e tyre.¹⁴ Shumica e KZK-ve kanë përfunduar me formimin e KZ-ve dhe kanë filluar me trajnimet. KZK-të duket se në përgjithësi e gëzojnë besimin e aktorëve lokalë.

VI. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Të gjithë qytetarët që kanë mbushur 18 vjet deri në ditën e zgjedhjeve kanë të drejtë të votojnë, përveç nëse kjo e drejtë ligjore u është marrë me vendim gjyqësor. Banorët e regjistruar në vend janë të përfshirë në regjistrin e votuesve nëse posedojnë letërnjoftim të vlefshëm ose pasaportë. Votuesit, të cilëve u ka skaduar ose do t'u skadojë afati i vlefshmërisë së dokumenteve për identifikim para ditës së zgjedhjeve, janë përjashtuar automatikisht nga listat e votuesve, përveç nëse e kanë rinovuar dokumentin e tyre dhe e kanë njoftuar zyrën rajonale të KSHZ-së për këtë ndryshim përpara se të mbyllet lista e votuesve. Disa bashkëbisedues të MVZ-së të ODIHR-it shprehën pakënaqësi nga çregjistrimi automatik i votuesve, të cilëve u kishte skaduar afati i vlefshmërisë së dokumenteve për identifikim.

Sistemi i regjistrimit për votimin në vend është pasiv dhe i vazhdueshëm, dhe bazohet në informatat e nxjerra nga regjistrat civilë dhe regjistrat e tjerë kombëtarë.¹⁵ KSHZ-ja është organi përgjegjës për mirëmbajtjen dhe përditësimin e regjistrit të votuesve, në bashkëpunim me Entin Shtetëror Statistikor, i cili e administron përpunimin organizativ, teknik dhe metodologjik të të dhënave.

Të gjithë qytetarët kanë të drejtë t'i kontrollojnë onlajn të dhënat e tyre në regjistrin e votuesve dhe të kërkojnë ndryshime gjatë gjithë vitit. Ndërmjet 23 shkurtit dhe 14 marsit, listat e votuesve u nxorën për këqyrje publike në zyrat rajonale të KSHZ-së.¹⁶ MVZ-ja e ODIHR-it vërejti disa zyra në të cilat lista e votuesve nuk ishin nxjerrë. Në përputhje me ligjin, KSHZ-ja siguroi kopje të regjistrit të votuesve për pesë parti parlamentare në bazë të kërkesës nga ana e tyre, pas përfundimit të këqyrjes publike, ndërsa ndryshimet e kërkuara nga partitë u shqyrtuan brenda afatit ligjor.¹⁷

Regjistri përfundimtar i votuesve deri më 29 mars përfshin 1.808.131 votues. Përderisa disa bashkëbisedues të MVZ-së të ODIHR-it theksuan sa ka përmirësime në saktësinë e regjistrit të votuesve, të tjerët shprehën shqetësime se ai përfshin votues të vdekur dhe qytetarë që nuk banojnë më në vend, si dhe mospërputhje në të dhënat e adresës që mund të çojë në shpërndarjen e gabuar të votuesve nëpër vendvotime.

Qytetarët me vendbanim të përhershëm në vend dhe me pasaportë të vlefshme, që banojnë përkohësisht jashtë vendit, janë përfshirë në regjistrin e votuesve dhe kanë të drejtë të regjistrohen për votim në përfaqësitë e caktuara diplomatike ose konsullore. KSHZ-ja ka regjistruar 1.781 votues për votim jashtë vendit.¹⁸

¹⁴ Për shembull KZK-të në Shtip, Gradsko dhe Kavadar.

¹⁵ Ministria e Punëve të Brendshme i ofron KSHZ-së informata për qytetarët që e kanë arritur moshën e pjekurisë dhe për lëshimin e letërnjoftimeve dhe pasaportave në bazë të regjistrave të shtetësisë dhe të vendbanimit. Gjykatat themelore duhet ta informojnë KSHZ-në për qytetarët e privuar nga e drejta ligjore për të votuar dhe ata që gjenden në paraburgim. Ministria e Drejtësisë ofron informata për personat e vdekur.

¹⁶ Sipas KSHZ-së, 53.972 votues i vizituan zyrat rajonale për t'i kontrolluar të dhënat e tyre, duke i përfshirë edhe votuesit që erdhën për t'u nënshkruar në listat për emërimin e kandidatëve. Si rezultat i këqyrjes publike, 517 votues u futën në listat e votuesve, 412 u përjashtuan, ndërsa të dhënat e 129 votuesve u korrigjuan.

¹⁷ KSHZ-ja njoftoi se të gjitha partitë parlamentare përveç BDI-së morën nga një kopje të regjistrit të votuesve për kontrollim. VMRO-DPMNE-ja kërkoi përfshirjen e 50 votuesve në listë, mirëpo KSHZ-ja e refuzoi këtë për shkak të mungesës së dokumenteve të vlefshme ose për shkak se tashmë ishin të regjistruar.

¹⁸ Votimi jashtë vendit do të administrohet në 32 zyra diplomatike dhe konsullore, ku janë regjistruar të paktën 10 votues. Sipas KSHZ-së, janë bërë 1.826 kërkesa për votim jashtë vendit.

VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Sipas Kushtetutës, një shtetas mbi moshën 40 vjeçare, i cili ka jetuar në vend së paku 10 nga 15 vitet e fundit, ka të drejtë të kandidojë për postin e kryetarit të vendit. Kandidatët mund të emërohen prej së paku 10.000 votuesve ose 30 deputetëve. Nënshkrimet për mbështetje nga votuesit duhet të mblidhen përpara zyrtarëve në hapësirat e zyrave rajonale të KSHZ-së në afat prej 15 ditësh.¹⁹ Votuesit me nënshkrimin e tyre mund të mbështesin më shumë kandidatë.

Nëntë kandidatë potencialë e njoftuan KSHZ-në për qëllimin e tyre për të mbledhur nënshkrime, ndërsa tre prej tyre e mblodhën numrin e nevojshëm të nënshkrimeve brenda periudhës së caktuar, prej 23 shkurtit deri më 9 mars.²⁰ KSHZ-ja i pranoi dhe i shqyrtoi dokumentet për emërim brenda afatit ligjor, dhe tre kandidatë u regjistruan më 21 mars, duke përfshirë një grua dhe një shqiptar etnik.²¹ Edhe pse jo-partiakë, secili nga tre kandidatët u mbështet nga parti politike para regjistrimit të tyre.

VIII. FUSHATA

Në përputhje me Kodin Zgjedhor, periudha zyrtare e fushatës filloi më 1 prill dhe do të përfundojë 24 orë para ditës së zgjedhjeve. Edhe pse Kodi Zgjedhor parasheh sanksione për garuesit që do të zhvillojnë fushatë jashtë periudhës së përcaktuar, ai përmban disa paqartësi sa i përket zhvillimit të hershëm të fushatës. Para se kandidatët të regjistrohen zyrtarisht më 21 mars, ata u angazhuan në aktivitete të fushatës, siç ishin takimet e vogla me qytetarët anembanë vendit dhe dhanë intervista për mediat. Siç parashihet me ligj, kandidatët e ndërprejnë fushatën pas regjistrimit të tyre formal, edhe pse partitë politike vazhduan t'i prezantojnë programet e tyre, duke i kritikuar kundërshtarët e tyre dhe duke i mbështetur kandidatët presidencialë pas të cilëve qëndrojnë.²² Më 26 mars, kryetarët e LSDM-së dhe të VMRO-DPMNE-së morën pjesë në një debat publik të emetuar nga transmetuesi komercial *Kanal 5*, gjatë të cilit të dytë i mbështetën kandidatët presidencialë pas të cilëve qëndrojnë partitë e tyre. Të tre kandidatët e shënuan fillimin e periudhës së fushatës me ngjarje të hapjes së fushatës më 1 prill. Bilborde me posterë ku ishin shfaqur kandidatët u paraqitën në shumë vende.

Kodi Zgjedhor përmban dispozita të hollësishme që e rregullojnë fushatën, të cilat kanë për qëllim të sigurojnë terren të barabartë për garuesit në zgjedhje duke e shfrytëzuar hapësirën publike në mënyrë të barabartë dhe duke e ndaluar keqpërdorimin e burimeve shtetërore. Nga pjesëmarrësit në zgjedhje kërkohet që t'i njoftojnë autoritetet së paku 48 orë përpara mbajtjes së një ngjarjeje të fushatës në vend publik.²³ Kodi Zgjedhor parasheh moratorium për shpalljen e projekteve të reja të financuara me mjete publike dhe e ndalon përdorimin e zyrave, pajisjeve apo punonjësve shtetërorë. Më 27 mars, Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë prezantoi një mjet onlajn, nëpërmjet të cilit punonjësit publikë mund ta denoncojnë çdo rast të presionit mbi ta. Siç kërkohet nga Kodi Zgjedhor, më 31 mars, kandidatët nënshkruan kod të sjelljes së mirë, duke premtuar të mos ushtrojnë presion mbi punonjësit e sektorit publik.

¹⁹ 45 zyra plotësuese u hapën përkohësisht nga KSHZ-ja për mbledhjen e nënshkrimeve në disa zona ku KSHZ-ja nuk ka zyrë rajonale.

²⁰ Dy kandidatë të pasuksesshëm ia shprehën pakënaqësinë e tyre KSHZ-së dhe MVZ-së së ODIHR-it duke pretenduar se kanë pasur pengesa për mbledhjen e nënshkrimeve, duke përfshirë edhe orë të parregullta të punës të zyrave rajonale të KSHZ-së.

²¹ Sipas KSHZ-së, z. Reka u mbështet me 11.128 nënshkrime të votuesve, znj. Siljanovska Davkova me 15.926, dhe z. Pendarovski me 31.729 nënshkrime.

²² KSHZ-ja i hodhi poshtë tre kundërshtime për fushatë të hershme nga znj. Siljanovska Davkova dhe z. Pendarovski.

²³ Disa objekte nuk mund të përdoren për ngjarje të fushatës, duke përfshirë objektet fetare, spitalet, shkollat, shtëpitë e pleqve dhe institucionet e tjera publike, përveç nëse nuk ka ndonjë vend tjetër të përshtatshëm që është në dispozicion.

Maqedonia e Veriut është shtëpi e disa pakicave kombëtare, duke përfshirë boshnjakët, romët, turqit, serbët dhe vllahët, si dhe popullsinë e konsiderueshme etnike shqiptare. Ndër çështjet kryesore për të cilat kandidatët presidencialë kanë dallime është ligji i ri që e zgjeron statusin zyrtar të gjuhës shqipe në gjithë vendin.²⁴ Ky ligj mbështetet fuqimisht në gjithë spektrin e partive shqiptare etnike dhe nga LSDM-ja. Në përputhje me qëndrimin e VMRO-DPMNE-së, znj. Siljanovska Davkova e kundërshton ligjin, ndërsa dy kandidatët e tjerë e mbështesin atë.

Në përgjithësi, gratë nuk janë të përfaqësuara në mënyrë adekuate në jetën publike. Për shembull, vetëm katër nga 26 ministra qeveritarë janë gra, dhe vetëm gjashtë nga 81 kryetarë të komunave janë gra. Të drejtat e grave dhe barazia gjinore ende nuk janë shfaqur si çështje të rëndësishme të fushatës. Znj. Siljanovska Davkova u përball me stereotipe negative në mediat sociale në bazë të gjinisë së saj, si për shembull komente rreth pamjes së saj.

IX. FINANCIMI I FUSHATËS

Financimi i fushatës është i rregulluar me Kodin Zgjedhor dhe Ligjin për Financimin e Partive Politike. Partitë kanë të drejtë për mjete publike nëse kanë fituar së paku një për qind të votave në zgjedhjet paraprake parlamentare apo lokale.²⁵ Kandidatët presidencialë nuk marrin mjete publike në mënyrë të drejtpërdrejtë, por shpenzimet për reklamimin politik do të kompensohen nga buxheti i shtetit.

Garuesit në zgjedhje janë të obliguar të regjistrojnë numra unikë tatimorë dhe të hapin llogari të veçanta bankare përmes të cilave duhet të kryhen të gjitha transaksionet financiare që lidhen me fushatën. Donacionet janë të kufizuara në 3.000 euro për individët dhe 30.000 euro për personat juridikë, duke i përfshirë edhe kontributet në natyrë.²⁶ Nuk ka rregulla të qarta për zhvillimin e fushatës nga palët e treta dhe nuk ka kërkesa për llogaridhënie për shpenzimet e bëra nga partitë politike që i mbështesin kandidatët e propozuar nga një grup votuesish. Të tre kandidatët e informuan MVZ-në e ODIHR-it se do të mbështeten në infrastrukturën e partive politike dhe mbështetjen e tyre logjistike. Kufiri i shpenzimeve të fushatës është 110 denarë për votues të regjistruar (gjithsej kap vlerën prej rreth 198 milionë denarësh ose rreth 3.2 milionë euro).²⁷

Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) është organi kryesor mbikëqyrës për financimin e partive politike dhe fushatave. Megjithatë, institucione të ndryshme kanë mandate përputhëse për t'i hetuar dhe për t'i zbatuar rregullat e financimit të fushatës.²⁸ Garuesit në zgjedhje duhet t'i dorëzojnë dy raporte të përkohshme dhe një raport përfundimtar mbi të ardhurat dhe shpenzimet e tyre KSHZ-së, ESHR-së dhe Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK).²⁹ Ligji i obligon këto institucione t'i publikojnë raportet e përkohshme të financimit të fushatës të çdo garuesi, megjithatë,

²⁴ Ky ligj, si dhe ratifikimi i Marrëveshjes së Prespës, u shpall në janar 2019, përkundër refuzimit të kryetarit të shtetit në largim që ta nënshkruajë atë.

²⁵ Sipas ndryshimeve të Ligjit për Financimin e Partive Politike të vitit 2018, shumica e mjeteve publike për partitë politike u rrit nga 0.06 në 0.15 për qind të të ardhurave përgjithshme të buxhetit të shtetit.

²⁶ Donacionet anonime janë të ndaluara, si dhe ato nga institucionet publike ose burimet e huaja, shoqatat e qytetarëve dhe grupet fetare.

²⁷ 1 euro është përafërsisht 61 denarë.

²⁸ Sipas ligjit, edhe ESHR-ja edhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit mund të iniciojnë raste në lidhje me shkeljen e rregullave për financimin e fushatës. Edhe pse Kodi Zgjedhor (neni 74-a) i urdhëron ESHR-së t'i shqyrtojë kundërshtimet në lidhje me shkeljet e financimit të fushatës, ESHR-ja e informoi MVZ-në e ODIHR-it se nuk ka kompetencë për t'i shqyrtuar kundërshtimet e tilla.

²⁹ Më 4 mars 2019, këto tre institucione nënshkruan një memorandum për shkëmbimin e informatave për parregullsitë në raportet financiare dhe për masat pasuese që duhet të ndërmerren.

nuk ka kërkesë për t'i shqyrtuar ato në hollësi. Raportet përfundimtare duhet të dorëzohen brenda katër muajve nga zgjedhjet dhe ESHR-ja duhet ta bëjë revizionin e tyre.³⁰

KSHPK-ja e sapo emëruar filloi punën në shkurt të vitit 2019 pas miratimit të Ligjit të ri për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave.³¹ KSHPK-ja ka mandat ta monitorojë ligjshmërinë e financimit të fushatës, të pranojë kundërshtime për shkeljet e parimit të ndarjes midis shtetit dhe partive politike, keqpërdorimin e burimeve shtetërore, blerjen e votave dhe presionin ndaj votuesve. KSHPK-ja e informoi MVZ-në e ODIHR-it se burimet e saj janë të kufizuara dhe një numër i procedurave që parashihen me ligj ende nuk zbatohen.³² KSHPK-ja nënshkroi një marrëveshje me Platformën e organizatave të shoqërisë civile (OSHC) kundër korrupsionit për të ndjekur dhe për të informuar për keqpërdorimin e burimeve shtetërore dhe për shkeljet e tjera të ligjeve. Megjithatë, disa prej këtyre OSHC-ve e informuan MVZ-në e ODIHR-it dhe KSHPK-në se nuk planifikojnë asnjë aktivitet për këto zgjedhje për shkak të mungesës së burimeve.

X. MEDIAT

Ambienti mediatik është i larmishëm, dhe përbëhet nga rreth 250 media, duke përfshirë 58 kanale televizive (15 kombëtare), 70 radio stacione, 20 botime të shtypura dhe 100 portale onlajn të lajmeve. Megjithatë, funksionimi i një numri të këtyre mediave është mjaft i kufizuar.³³ Televizioni mbetet burimi më i rëndësishëm i informacionit politik, me programe të shumta ditore politike. Përveç kësaj, roli i mediave onlajn dhe i rrjeteve sociale si platforma të diskutimit politik gradualisht rritet.

Në fund të vitit 2018, qeveria futi subvencione për gazetatat me qëllim të mbështetjes së këtij segmenti të mediave. Legjislacioni për mediat u ndryshua për ta ndaluar praktikën shumëvjeçare të institucioneve publike që i përdornin mjetet publike për reklamimin e tyre përmes mediave transmetuese. Transmetuesi publik është i financuar ekskluzivisht nga buxheti i shtetit që nga viti 2017. Shumë bashkëbisedues të MVZ-së ODIHR-it theksuan se një praktikë e tillë mund ta dobësojë pavarësinë e transmetuesit publik.

Shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it i theksuan përmirësimet në lirinë e përgjithshme të mediave në vitet e fundit. Në të njëjtën kohë, këto palë të interesuara vunë në dukje ambientin e mbingarkuar të mediave brenda një tregu të kufizuar për reklamim, rogat e ulëta dhe rënien e interesit për profesionin e gazetarisë, gjë që paraqet një shqetësim për cilësinë e raportimit. Një numër i mediave private mbeten të financuara nga biznese të afërta me grupe të ndryshme politike, ndërsa disa bashkëbisedues pretenduan se këto media janë përdorur si dorë e zgjatur politike, me ç'rast vetëm disa media janë të vetë-qëndrueshme, në veçanti kanalet televizive kryesore private.

Korniza ligjore parasheh rregullim të hollësishëm të sjelljes së mediave gjatë fushatës zgjedhore. Kodi Zgjedhor parasheh se transmetuesit që i mbulojnë zgjedhjet janë të obliguar që këtë ta bëjnë në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme në të gjitha përmbajtjet e tyre programore. Përkundër ndryshimeve të fundit të 27 marsit, disa dispozita i referohen vetëm mbulimit të partive politike apo prezantimit të tyre, e jo edhe garuesve. Sipas vendimeve të Agjencisë për Shërbime Audio dhe

³⁰ Sipas ESHR-së, në bazë të revizionit të saj të raporteve për financimin e fushatës për zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 dhe zgjedhjet lokale të vitit 2017, nuk u gjetën shkelje.

³¹ KSHPK-ja e re u emërua nga parlamenti pas thirrjes publike dhe procedurës publike të përzgjedhjes; anëtarët e mëparshëm të komisionit dhanë dorëheqje në fillim të vitit 2018.

³² Duke përfshirë qasjen në bazat e të dhënave të institucioneve publike për shkëmbimin e shpejtë të informatave.

³³ Të dhënat sipas [Indeksit për qëndrueshmërinë e mediave të IREX-it për vitin 2018](#).

Audiovizuele Mediatike (ASHAAM) dhe të Transmetuesit publik këto dispozita ose nuk vlejné për zgjedhjet presidenciale ose duhet të vlejné edhe për garuesit edhe për partitë politike.³⁴

Transmetuesi publik është i obliguar të emetojë prezantim politik falas, ndërsa llojet e tjera të mediave, duke i përfshirë edhe portalet në internet, kanë të drejtë të ofrojnë reklama të paguara.³⁵ Bashkëbisedues të shumtë të MVZ-së së ODIHR-it e vunë në pikëpyetje praktikën e sapo futur të kompensimit të reklamimit politik në mediat private me mjete publike.³⁶ Më 9 shkurt, ASHAAM filloi ta monitorojë respektimin e kërkesave për mbulimin e fushatës nga ana e mediave, në bazë të metodologjisë së saj të miratuar më 7 shkurt. Deri më tani, Agjencia ka publikuar një raport gjithëpërfshirës nga monitorimi.³⁷

Më 18 mars, MVZ-ja e ODIHR-it filloi monitorimin e saj cilësor dhe sasior mediatik të tetë kanaleve televizive, si dhe katër mediave onlajn dhe tre mediave të shkruara.³⁸ Mediat në përgjithësi e kanë respektuar periudhën kur nuk duhet të ketë fushatë, edhe atë ndërmjet regjistrimit të kandidatëve dhe fillimit zyrtar të fushatës, pasi në programe nuk u paraqitën kandidatët.

XI. KUNDËRSHTIMET DHE ANKESAT

KSHZ-ja e trajton shumicën e kontesteve administrative në lidhje me zgjedhjet, ndërsa ESHR-ja dhe KSHPK-ja i trajtojnë kundërshtimet në lidhje me financimin e fushatës dhe keqpërdorimin e burimeve shtetërore, respektivisht.³⁹ Gjykatat Themelore kanë kompetencë mbi shkeljet zgjedhore.⁴⁰ Shumica e afateve kohore për parashtimin dhe zgjidhjen e kundërshtimeve, duke i përfshirë edhe kundërshtimet në lidhje me regjistrimin e votuesve dhe të kandidatëve, si dhe parregullsitë në ditën e zgjedhjeve, janë të shkurta. Ndërkohë, rastet e shkeljeve të rregullave të fushatës do të trajtohen nga KSHZ-ja brenda një afati prej shtatë ditësh.

Përderisa vendimet e KSHZ-së në lidhje me kundërshtimet dhe anulimin e rezultateve mund të rishqyrtohen nga Gjykata Administrative, e cila është instanca e fundit në pothuajse të gjitha rastet,

³⁴ Kodi Zgjedhor (neni 76-a (2)) përcakton ndarje specifike të lajmeve të fushatës zgjedhore të transmetuesit publik në mes të ngjarjeve ditore nga vendi dhe bota (30 për qind), partive në pushtet (30 për qind), partive opozitare (30 për qind) dhe partive që nuk janë të përfaqësuara në Kuvend (10 për qind). Në mbledhjen e saj publike, Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuele Mediatike interpretoi se kjo dispozitë nuk është e vlefshme për fushatën aktuale presidenciale. Një dispozitë tjetër (neni 76-a (11)) kërkon që transmetuesi publik të organizojë debate me partit kryesore, si dhe me pjesëmarrësit e tjerë në procesin zgjedhor. Udhëzimi për prezantimin mediatik, i publikuar nga transmetuesi publik më 14 shkurt e ruajti këtë kërkesë.

³⁵ Sipas ueb-faqes së KSHZ-së, ka 92 transmetues (43 kanale televizive dhe 49 radio stacione) dhe 6 gazeta që e respektuan afatin për t'i publikuar çmimet e tyre për reklamat e paguara. Përveç kësaj, 83 media onlajn janë regjistruar në KSHZ për qëllime të reklamimit të paguar.

³⁶ Kjo praktikë u fut me ndryshimet e Kodit Zgjedhor të bëra në korrik të vitit 2018.

³⁷ ASHAAM-i planifikon të publikojë një raport gjatë fushatës. Ajo bën monitorim 24 orë çdo ditë të javës të 15 kanaleve televizive para fushatës dhe 32 kanaleve gjatë fushatës, dhe përfshin vlerësimin e tonit të mbulimit.

³⁸ Monitorimi bëhet çdo ditë nga ora 18:00 deri në orën 24:00 në kanalet *RTM1* dhe *RTM2* (në gjuhën maqedonase dhe shqipe, respektivisht) dhe kanalën privat *Alfa* (në gjuhën maqedonase), *Alsat-M* (dygjuhësh), *Kanal 5*, *Sitel*, *Telma*, *24 Vesti* (në gjuhën maqedonase). Artikujt që kanë të bëjnë me politikën e gazetave private *Koha* (në gjuhën shqipe), *Nezavisen* dhe *Nova Makedonia* (në gjuhën maqedonase), si dhe të mediave onlajn www.kurir.mk (në gjuhën maqedonase), www.lajmpress.org (në gjuhën shqipe), www.plusinfo.mk dhe www.sdk.mk (në gjuhën maqedonase) janë gjithashtu të monitoruara.

³⁹ Ligji parasheh që KZK-të të vendosin për kundërshtimet, por nuk e specifikon se cilat kundërshtime janë nën kompetencën e tyre. KSHZ-ja e informoi MVZ-në e ODIHR-it se në praktikë, KZK-të nuk do t'i shqyrtojnë kundërshtimet.

⁴⁰ Edhe pse Kodi Zgjedhor (neni 73) kandidatëve ua jep të drejtën që drejtpërdrejtë të ngrejné procedurë në Gjykatën Themelore përkatëse, nëse dikush ndërhyr në fushatën e tyre, në praktikë, sipas bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, individët duhet së pari ta iniciojnë rastin në prokurori dhe nuk mund t'i drejtohen drejtpërdrejt gjykatës.

vendimet dhe veprimet e tjera nuk i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor. Kundërshtimet e votuesve janë të kufizuara në shkëlqen e të drejtës së tyre për të votuar. Vëzhguesit qytetarë nuk kanë të drejtë të parashtrajnë kundërshtime, ndërsa vetëm garuesit mund t'i kontestojnë parregullsitë e votimit dhe rezultatet e zgjedhjeve.

Sistemi elektronik për menaxhimin e rasteve dhe të kundërshtimeve nga ana e KSHZ-së, siç kërkohet nga Kodi Zgjedhor, është zhvilluar, por ende nuk është funksional. Deri më sot, janë parashtruar një numër shumë i vogël i kundërshtimeve në lidhje me zgjedhjet.⁴¹ Kundërshtimet e dy kandidatëve të pasuksesshëm në lidhje me procesin e mbledhjes së nënshkrimeve nuk u pranuan nga KSHZ-ja pasi ligji nuk u jep të drejtë votuesve të parashtrajnë kundërshtime të tilla. Përgjigjet me shkrim të KSHZ-së nuk konsiderohen vendime zyrtare dhe nuk mund të apelojnë.⁴²

XII. VËZHguesIT QYTETARË DHE NDËRKOMBËTARË

Kodi Zgjedhor parasheh vëzhgimin e gjithë procesit zgjedhor edhe nga vëzhguesit vendorë edhe nga ata ndërkombëtarë. Për t'u akredituar, shoqatat e vendit dhe organizatat e huaja duhet të jenë regjistruar së paku një vit përpara ditës së zgjedhjeve dhe statutet e tyre të themelimit duhet ta përfshijnë parimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Aktiviteti më i madh për vëzhgimin qytetar të zgjedhjeve pritet nga Asociacioni qytetar MOST, i cili e informoi MVZ-në e ODIHR-it se kishte shpërndarë vëzhgues afatshkurtër në të gjitha 80 komunat dhe se ka në plan të shpërndajë mbi 1.500 vëzhgues afatshkurtër në ditën e zgjedhjeve. Disa shoqata të personave me aftësi të kufizuara po ashtu planifikojnë t'i vëzhgojnë zgjedhjet e ardhshme.

XIII. AKTIVITETET E MVZ-SË SË ODIHR-IT

MVZ-ja e ODIHR-it e filloi punën e saj më 11 mars. Shefi i MVZ-së së ODIHR-it u takua me ministrin e punëve të jashtme, Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Entin Shtetëror të Revizionit, Agjencinë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike, Gjykatën Administrative, kandidatët dhe kryetarët e partive, përfaqësuesit e vendeve pjesëmarrëse të OSBE-së dhe të organizatave ndërkombëtare. MVZ-ja e ODIHR-it gjithashtu ka vendosur kontakte me shoqërinë civile, përfaqësuesit e mediave dhe palët e tjera të përfshira në procesin zgjedhor.

Asambleja Parlamentare e OSBE-së (AP e OSBE-së) dhe Kuvendi Parlamentar i Këshillit të Evropës (KPKE) planifikojnë të dërgojnë delegacione për të vëzhguar ditën e zgjedhjeve. Znj. Sereine Mauborgne është emëruar nga kryesuesi i OSBE-së si koordinatorë e posaçme dhe udhëheqëse e misionit vëzhgues afatshkurtër të OSBE-së. Vëzhgimi i ditës së zgjedhjeve do të jetë rezultat i përpjekjes së përbashkët që e përfshin ODIHR-in dhe delegacionet AP të OSBE-së dhe KPKE-së.

***Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.
Janë siguruar edhe përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.***

⁴¹ KSHZ-ja pranoi dhe e refuzoi një kundërshtim në lidhje me regjistrimin e votuesve dhe tre kundërshtime në lidhje me zhvillimin e hershëm të fushatës. Gjykata Administrative e vërtetoi vendimin e KSHZ-së për të mos e përfshirë një votues në listën e votuesve për shkak të mungesës së dokumenteve të vlefshme dhe vendbanimit zyrtar. Organet e tjera administrative dhe gjykatat e tjera nuk kanë pranuar asnjë kundërshtim në lidhje me zgjedhjet.

⁴² Gjykata Administrative i hodhi poshtë dy padi të tilla nga një medie, e cila e humbi afatin për shpalljen e listës së çmimeve dhe për këtë arsye nuk u miratua nga KSHZ-ja për reklamim të paguar politik.